



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

---

Numri i lëndës: 2020:000702

Datë: 23.02.2021

Numri i dokumentit: 01533509

**C.nr.22/2020**

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN-Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil,** me gjyqtaren Mirvete Alidemi dhe bashkëpunëtorin profesional Baki Sylejmani, në çështjen kontestimore të paditësve: Q.K, R. S. D, S. S dhe L. F të gjithë me vendbanim në ..., të cilin sipas autorizimit i përfaqëson, avokati Labinot Buzuku Sh.P.K – nga Prishtina, me adresë në fshatin Hajvali, rruga “Mramori”, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit, me objekt kontesti kompensimin e pagave jubilar dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit ditor, pas mbajtjes së shqyrtimit kryesor e publik, më datën 26 Nëntor 2020 mori, ndërsa e përpiloi me shkrim me datën 4 Janar 2021 këtë:

**AKTGJYKIM**

**I.MIRATOHET pjesërisht** si e bazuar kërkesëpadia e paditësve: Q.K, R. S. D, S. S dhe L. F nga ... dhe **DETYROHET** e paditura Komuna e Gjilanit – Drejtoria Komunale e Arsimit që paditësve t’ia kompensojë shumën e përgjithshme prej 5,018,75€ edhe atë :

-Q.K, në emër të kompensimit për ushqimin ditorë gjatë punës prej 2 (dy euro) € në ditë pune, duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datë 28.02.2020, respektivisht për 480 ditë pune të realizuara, shumën prej 960.00 €,

-R. S shumën e përgjithshme prej 1,304.25 €/cent, edhe atë në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e tij të punës mbi 28 vite respektivisht shumën prej 344.25 € dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për 2 (dy) € në ditë pune, duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.02.2020, për 480 ditë pune, shumën prej 960.00 €,

-Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit e R. S në shumë prej 34.64 € e kërkuar më tepër se sa shuma e gjykuar, refuzohet si e pabazuar.

-S. D shumën e përgjithshme prej 1,304.25 €/cent, dhe atë në emër të shpërblimit jubilar për përvojën mbi 22 vite, respektivisht shumën prej 344.25 dhe në emër të kompensimit për ushqim ditor gjatë punës prej 2 (dy euro) € në ditë pune, duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.02.2020, për 480 ditë pune, shumën prej 960.00 €.

-Pjesa tjetër e kërkesëpadiës së paditësit R. S në shumë prej 35.75 € e kërkuar më tepër se sa shuma e gjykuar, refuzohet si e pabazuar.

-S.S, shumën e përgjithshme prej 1,304.25 €/cent, dhe atë në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e tij mbi 25 vite, shumën prej 344.25 dhe në emër të kompensimit për ushqim ditorë

gjatë punës për 2 (dy) € në ditë pune, duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.02.2020, për 480 ditë pune, shumën prej 960.00 €.

-Pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit R. S në shumë prej 35.75 € e kërkuar më tepër se sa shuma e gjykuar, refuzohet si e pabazuar dhe paditësit

-L.F shumë e përgjithshme prej 1,106.00 €, dhe atë në emër të kompensimit të ushqimit për ditët në punë, për periudhën kohore nga dt.18.04.2017 e deri me datën 11.03.2020, për 553 ditë pune.

Të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, dhe atë të gjitha këto në afat prej 7 ditësh pas ditës së pranimit të vendimit, nën kërcënimin të përmbarimit të dhunshëm.

**II.OBLIGOHET** e paditura që paditësit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në shumë prej 737 €, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

### **A r s y e t i m i**

Paditësit, përmes të autorizuarit të tyre më datën 06.01.2020, në këtë gjykatë kanë paraqitur padi ndaj të paditurës, për pagimin e shpërblimit jubilar dhe kompensimin e shpenzimeve të ushqimit dhe kanë kërkuar nga gjykata që ta detyrojë të paditurën që paditësve: Q.K, R. S. D, S. S dhe L. F të gjithë nga ... që paditësve t'ia kompensojë shumë e përgjithshme prej 6,090.77 €, në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar dhe kompensimin e ushqimit, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8 % në afat prej 7 ditëve nga dita kur aktgjykimi të merr formën e prerë nën kërcënimin e përmbarimit, meqë edhe për kundër faktit që fillimisht kanë kërkuar nga organet administrative për kompensimin e kërkesave të tyre por një e drejtë e tyre nuk është realizuar në rrugë administrative.

Gjykata në këtë çështje juridike kontestimore pas shqyrtimit paraprak të padisë ka nxjerr aktvendimin për përgjigje në padi më datën 03.02.2020, ku e paditura aktvendimin së bashku me padinë e ka pranuar më datën 05.06.2020 e cila datë është vërtetuar përmes fletëkthesës së gjykatës. Me aktvendimin për përgjigje në padi, gjykata e ka njoftuar të paditurin për detyrimin ligjor për dhënie të përgjigjes në padi dhe për pasojat ligjore që do ti ketë nëse nuk paraqet përgjigje në padi, për mundësinë që gjykata të marrë aktvendim për shkak të mosbindjes.

E paditura në përgjigje në padi e ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësit për arsye se në bazë të nenit 68 lidhur me nenin 67 të Ligjit për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, gjykata duhet t'a pezullojë rastin në afat prej 180 ditësh si dhe ta njoftoj Ministrinë e Drejtësisë mbi rastin konkret, pastaj ka konsideruar se Gjykata Themelore nuk ka kompetencë lëndore në këtë çështje dhe si kompetente ka potencuar që është Departamenti Adimistrativ i Gjykatës Themelore të Prishtinës. Po ashtu e njejta pretendimet e saj i bazon në Kontratën e Përgjithshme Kolektive të Kosovës e miratuar dhe nënshkruar nga MASHT (Ministria e Arsimit, Shkencës, dhe Teknologjisë) dhe SBASHK (Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës), respektivisht në dispozitat e nenit 35 pika 8 dhe nenit 35 pika 67 të kësaj kontrate, gjersa ka konsideruar se kjo kontratë nuk prodhon efekte juridike dhe nuk krijon të drejta dhe detyrime ndaj Komunës së Gjilanit si e paditur në këtë rast. Po ashtu ka theksuar se kjo kontratë nuk është në fuqi për disa arsye konkrete: Ligji Nr.04/L-131 për skemat pensionale të financuara nga shteti i dt. 06 Maj 2014 nuk ka paraparë një të drejtë të tillë sipas padisë dhe kërkesëpadisë

dhe se çdo marrëveshje që parasheh të drejta jashtë këtij ligji nuk prodhon kurrfarë efekti juridik. Tutje ka theksuar se kontratë kolektive në hyrje të saj bazohet në Ligjin e Punës i cili nuk parasheh një të drejtë të tillë të beneficioneve, pasi neni 77 i këtij ligji potencon se pensioni i vjetërsisë dhe i parakohshëm rregullohen me ligj të veçantë. Pagat jubilarë sipas Kontraës Kolektive të Arsimit mund të realizonte pas çdo 10 viteve dhe se afati i realizimit të kësaj kërkesë është 30 ditë nga koha e të drejtës për kompensim, ndërsa në rastin konkret kemi tejkallim të afatit ligjor të realizimit të kësaj kërkesë dmth paditësi nuk e ka kërkuar realizimin e kësaj kërkesë në afat prej 30 ditësh.

Përfaqësuesi i paditësve si në shqyrtimin gjyqësor ashtu edhe në fjalën përfundimtare ka mbetur në tërësi pranë padisë dhe kërkesëpadisë, duke theksuar që në bazë të provave të administruara, vërtetohet baza juridike e kërkesëpadisë dhe lartësia e saj dhe ka kërkuar nga gjykata që të aprovohet kërkesëpadia e precizuar me datën 15.07.2020 dhe paditësve t'iu kompensohet shuma e përgjithshme prej 6,090.77 €, në emër të pagave jubilarë dhe shpenzimet e ushqimit, po ashtu i njejtë ka kërkuar shpenzimet e procedurës kontestimore duke i specifikuar të njejtat.

Përfaqësuesi ligjor i të paditurës në shqyrtimin gjyqësor dhe në shpjegimet përfundimtare ka mbetur pranë përgjigjes në padi duke potencuar se sipas LMD-së dhe Ligjit të Punës sa i përket pagave jubilarë egziston parashkrim dhe njëherit ka konsideruar që kërkesë është vjetërsuar në mbështetje të Ligjit të Punës, nenit 78 pika 1, ngase nuk është adresuar asnjë kërkesë punëdhënësit që në procedurën administrative të realizoj këtë të drejtë, ku sipas këtij fakti nuk janë shterrur mjetet juridike – administrative, po ashtu i njejtë e ka kundërshtuar përfaqësuesin e paditësve sa i përket shpenzimeve dhe ka theksuar se ka vërejtje në to.

Gjykata për vërtetimin e drejtë dhe të plotë të gjendjes faktike dhe për ti vërtetuar pretendimet e palëve ndërgjyqëse në këtë çështje kontestimore ka administruar dhe vlerësuar këto prova materiale: Listat e pagave të lëshuara nga Buxheri i RKS-së nga data 01.11.2019 e deri me datën 30.11.2019 në emër të Q.K, R. S. D, S. S dhe L. F, vërtetimi mbi përvojën e punës nr.Prot.... në emër të Q. K ; Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar nr.... e datës 01.09.2015 për Qazim Kryeziun; Vërtetimi mbi përvojën e punës nr.protokolit ... në emër të R. S e datës 10.12.2019 ; Kontratat e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar nr.... e dt.01.09.2017, në emër të R.S; Vërtetimi mbi përvojën e punës nr.prot ... në emër të Sami Durmishit i datës 10.12.2019; Kontrata e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar nr.prot.... e dt.01.09.2017 në emër të Sami Durmishin ; Vërtetimi mbi përvojën e punës nr.prot.... në emër të S. S i datës 10.12.2019 ; Kontratat e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar nr.... e dt.01.09.2019 në emër të S. S ; Vërtetimi mbi përvojën e punës nr. prot. ... në emër të L. F e dt.10.12.2019 ; Kontratat e punës për mësimdhënës në kohë të pacaktuar nr.... e dt.15.11.2019 në emër të L. F ; Vërtetimi për ditët e pranisë në punë me nr. të protokoli ... i dt.28.02.2020 në emër të Q. K; Vërtetimi për ditët e pranisë në punë me nr.prot. ... i datës 28.02.2020 në emër të R. S Vërtetimi për ditët e praisë në punë me numër të protokolit ... i datës 28.02.2020 në emër të S. Di; Vërtetimi për ditët e pranisë në punë me numër të protokolit ... i datës 28.02.2020 në emër të S. S dhe Vërtetimi për ditët e pranisë në punë me nr.prot.... i dt.17.06.2020 në emër të L. F

Pas vlerësimit me kujdes të secilës provë veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 të LPK-ës si dhe në bazë të rezultatit të gjithëmbarshtëm të procedurës kontestimore, gjykata vërtetoi këtë gjendje faktike:

Se paditësi Q. K nga ...i ka filluar punën në Gjimnazin Natyror “Xhavit Ahmeti” në Gjilan në pozitën e mësimdhënësit të lëndës së muzikës që nga data 01.09.2005 deri në vitin 10.12.2019

dhe vazhdon të punoj edhe më tutje në këtë shkollë, fakt ky i vërtetuar nga Vërtetimi me nr.... i datës 10.12.2019 i lëshuar nga Sekretari i kësaj shkolle, nga i cili vërtetohet se i njëjti ka përvojë pune mbi 14 vite.

Paditësi R. S ka punuar në tri shkolla fillore ndërsa për momentin është duke punuar në Gjimnazin “Xhavit Ahmeti” në Gjilan në pozitën e mesimdhënësit të edukatës fizike, fakt ky i vërtetuar nga Vërtetimi me nr.... i datës 10.12.2019 i lëshuar nga sekretari i kësaj shkolle, nga i cili vërtetohet se i njëjti ka përvojë pune mbi 28 vite.

Paditësi S.D ka punuar në katër shkolla, ndërsa për momentin është duke punuar në Gjimnazin “Xhavit Ahmeti” në Gjilan, në pozitën e mësimitdhënësit të gjuhës shqipe, fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi me nr.... i dt.10.12.2019 i lëshuar nga sekretari i kësaj shkolle, nga i cili vërtetohet se i njëjti ka përvojë pune mbi 22 vite.

Paditësi S. S ka punuar në shkollën “Zenel Hajdini” dhe tani për momentin është i punësuar në shkollën “Xhavit Ahmeti” në Gjilan, në pozitën e mësimitdhënësit të gjuhës frënge dhe si koordinator i cilësisë, fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi me nr.... i dt.10.12.2019 i lëshuar nga sekretari i kësaj shkolle, nga i cili vërtetohet se i njëjti ka përvojë pune mbi 25 vite.

Paditësi L. F është në marrëdhënie punë që nga dt.01.09.2012 në Gjimnazin “Zenel Hajdini” në Gjilan ku ende vazhdon të punojë, në pozitën e mësimitdhënësit i lëndës së ekonomisë, fakt ky i vërtetuar nga vërtetimi me nr.... i dt.10.12.2019 i lëshuar nga sekretari i kësaj shkolle

Gjykata në këtë çështje kontestimore sa i përket të drejtës subjektive të paditësve dhe lartësisë së saj, ka zbatuar dispozitat e Kontratës Kolektive të Arsimit në Kosovë, të dt.18.04.2017 e cila ka hyrë në fuqi menjëherë konkretisht nenin 35 par.7 dhe 8 pika 8.1 dhe 8.2 të kësaj kontrate, ndërsa procedura është zhvilluar në bazë të Ligjit të Procedurës Kontestimore në fuqi.

Gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi dhe e aprovoj pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësve : Q. K ashtu që e obligoi të paditurën që paditësit t’ia paguaj në emër të kompensimit të ushqimit gjatë punës për 2 (dy) € në ditë pune, duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datë 28.02.2020, për 480 ditë pune të realizuara, shumën prej 960.00 €, si dhe R.S ashtu që e obligoi të paditurën që paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,304.25 €/cent edhe atë në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e tij të punës mbi 28 vite respektivisht shumën prej 344.25 € dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për 2 (dy) € në ditë pune, duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.02.2020, për 480 ditë pune, shumën prej 960.00 €, S.D ashtu që e obligoj të paditurën që paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,304,25 €, edhe atë në emër të shpërblimit jubilar për përvojën mbi 22 vite, respektivisht shumën prej 344.25 dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për 2 (dy) € në ditë pune, duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.02.2020, për 480 ditë pune, shumën prej 960.00 €, S. S ashtu që e obligoj të paditurën që paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,304.25 €/cent , edhe atë në emër të shpërblimit jubilar për përvojën e tij mbi 25 vite, shumën prej 344.25 dhe në emër të kompensimit për ushqim gjatë punës për 2 (dy) € në ditë pune, duke filluar nga data 18.04.2017 e deri me datën 28.02.2020, për 480 ditë pune, shumën prej 960.00 €, L. F ashtu që e obligoj të paditurën që paditësit t’ia paguajë shumën e përgjithshme prej 1,106.00 €, edhe atë në emër të kompensimit të ushqimit për ditët në punë, për periudhën kohore nga dt.18.04.2017 e deri me datën 11.03.2020, për 553 ditë pune edhe atë të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8%, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë e deri në pagesën definitive, gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga

dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit. Kurse këto shuma të aprovuara gjykata u bazua në Kontratën Kolektive të Arsimit parauniversitar të dt.18.04.2017, ku në nenin 35 par. 8 shprehimisht është përcaktuar se “ Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblim jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: kurse pika 8.1 parasheh “Për 10 vite të përvojës së punës në vlerë të 50% të një page bazë, 8.2 ku parashihet për 20 vjet të përvojës së punës në vlerë të 75 % të një page bazë dhe neni 8.5 ku shprehimisht parashihet se “Shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi kur i punësuarit i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kritereve përkatëse, ndërsa neni 35 par.7, të po kësaj kontrate ku është përcaktuar se “Të punësuarve, u sigurohen kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlëra e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë për një ditë pune është 2 (dy) euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arismore. Punëdhënësi i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve përmes restaurantit apo kuzhinës, ose në një formë tjetër nuk ka obligim kompensimin për ushqim. Në rastin konkret institucionet shkollore nuk e kanë të rregulluar ushqimin përmes restoranteve, andaj edhe e obligoj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj edhe shumën e lartëcekur në emër të ushqimit ditor.

Gjykata vendosi që pjesën tjetër të kërkesëpadisë të paditësve R. S, S. D dhe S. S të kërkuara më tepër se shuma e gjykuar t’a refuzojë si të pabazuara.

Lidhur me pretendimet e të paditurës se në rastin kemi parashkrim të kërkesës sa i përket shpërblimit jubilar , gjykata një pretendim të tillë e refuzoi me arsyetim se paditësit, padinë në gjykatë e kanë paraqitur me datën 06.01.2020, çka do të thotë se të njëjtit në afatin e paraparë ligjor në mbështetje të dispozitave të nenit 87 i Ligjit të Punës i cili në mënyrë shprehimore ka paraparë se “*Të gjitha kërkesat nga marrëdhënia e punës në para parashkruhen brenda afatit prej tri vitesh nga dita e paraqitjes së kërkesës*”, për më tepër Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar ka hyrë në fuqi me dt.17.04.2017 dhe në bazë të kësaj paditësit nuk kanë mundur ta ushtrojnë këtë kërkesë pasi që para kësaj date nuk ka qenë në fuqi kjo kontratë dhe e njëjta prodhon efekt nga momenti i nënshkrimit të saj.

Po ashtu për gjykatën është i pabazuar edhe pretendimi tjetër i të paditurës se Kontrata Kolektive e Arsimit Parauniversitar nuk prodhon efekt për të paditurën, ngase një pretendim i tillë është në kundërshtim me Ligjin për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës me nr.03L-068, ku në nenin 5 të këtij ligji janë të parapara kompetencat e komunave sa i përket punësimit të mësimdhënësve dhe pagesës së tyre e rrjedhimisht edhe detyrimet e parapara me Kontratë bien në barrë të të paditurës.

Kamata ligjore prej 8% në vit është përcaktuar në mbështetje të nenit 382 të LMD-ës, në të cilën dispozitë shprehimisht është përcaktuar se „Debitori që vonon në përmbushjen e detyrimit në të holla debiton, përpos borxhit kryesor, edhe kamatën”, kurse lartësia e kamatës vonesës është tetë përqind (8%) në vit, përveç nëse parashihet ndryshe me ligj të veçantë.

Gjykata vendosi si në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi në mbështetje të nenit 452.1 të LPK-ës që ta obligoj të paditurën që paditësit t’ia kompensoj shpenzimet e procedurës në shumë prej 737euro dhe ju referuar shpenzimeve me sa vijon: për përpilimin e padisë shumë prej 312 €, për taksë gjyqësore shumë prej 20 €, për një përfaqësim në një seancë shumë e të hollave në lartësi prej 405 €.

Andaj, nga arsyet e cekura më lartë, e në mbështetje të nenit 143 të LPK-ës, u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN**  
**C.nr.22/20, datë 4 Janar 2021**

**Gjyqtarja,**  
**Mirvete Alidemi**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi, është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit të Kosovës në Prishtinë, në afat prej 7 ditësh, pas ditës së pranimit të vendimit. Ankesa dorëzohet në kopje të mjaftueshme përmes kësaj gjykate.